



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV

Kryesia e Kuvendit

P-154

Prishtinë, më 18 prill 2014, në orën 12:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, E MBAJTUR MË 18 PRILL 2014

Në mbledhje morën pjesë: Jakup Krasniqi, kryetar i Kuvendit; Sabri Hamiti dhe Albert Kinolli, nënkryetarë të Kuvendit.

Nga grupet parlamentare: Adem Grabovci, Ismet Beqiri, Visar Ymeri, Myzejene Selmani dhe Sreten Ivanoviq.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit: Eshref Vishi dhe Skender Reçica;

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Xheladin Hoxha, Sali Rexhepi, Shefki Shoshaj dhe Sherif Konjufca.

Nga Zyra e Presidentit: Amir Haradinaj dhe

Nga OSBE-ja: Floriana Shala.

Mbledhjen e kryesoi **Jakup KRASNIQI**, kryetar i Kuvendit.

Kryetari e hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit të ditës.

Kryesia, me propozimin e kryetarit, i zhvilloi punimet me këtë:

Rend dite

1. Procedimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që ndërlidhen me mandatin e Misionit të Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Republikën e Kosovës.

* * *

Kryetari i Kuvendit i njoftoi anëtarët e Kryesisë së Kuvendit se letërkëmbimi ndërmjet Presidentes së Republikës së Kosovës, znj. Atifete Jahjaga dhe baroneshës Ketrin Eshton, përfaqësuese e lartë e Bashkimit Evropian për Politikë të Jashtme dhe Siguri, për mandatin e misionit të EULEX-it në Kosovë, është proceduar në Kuvend, por jo edhe Projektligji për ratifikimin e Marrëveshjes ndërkombëtare ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian mbi Misionin e Bashkimit Evropian për sundimin e Ligjit në Kosovë.

Diskutimi i kryetarit të Kuvendit është dhënë i plotë në transkript.

* * *

Kryesia, pas diskutimit, me pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare, vendosi që seanca plenare e radhës të mbahet më 23 prill 2014, në orën 10:00, me këtë:

Rend dite

1. Procedimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që ndërlidhen me mandatin e Misionit të Bashkimit Evropian për sundimin e ligjit në Republikën e Kosovës.

* * *

Kryetari konstatoi se Projektligji i lartpërmendur i propozohet seancës për shqyrtim në parim, për të cilin vendos seanca, sipas nenit 84 të Rregullores së Kuvendit.

Kryetari e deklaroi të mbyllur mbledhjen e Kryesisë në orën 12:20 minuta.

Kryetari i Kuvendit

Jakup KRASNIQI

Procesverbalin e hartoi:

Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale

